



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.03, datë 14.12.2022

PËR
MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR BASHKIA
VAU I DEJËS, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.3, DATË 27.04.2018
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, të Vendimit Nr.3, datë 27.04.2018 të KKT-së "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vau i Dejës", me propozim të Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës, si dhe referuar Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr. 81 datë 30.11.2022, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Vau i Dejës, të miratuar me Vendimin Nr.03, datë 27.04.2018, të Këshillit Kombëtar të Territorit, të bëhen ndryshime në dokumentin e:

- *Rregullores së Planit:*

- Pas nenit 18 "Madhësia e njësisë/ zonës me PDV", shtohet neni 18/1 "Rastet për të cilat bartimi i PDV-së nuk është i detyrueshëm dhe/ose i nevojshëm";
- Neni 23 "Përmirësimi i kushteve të banimit dhe ndërtimet në sistemin jourban", ndryshohet;
- Pas nenit 23 "Përmirësimi i kushteve të banimit dhe ndërtimet në sistemin jourban", shtohet neni 23/1 "Rregullat për zhvillimet në sistemet Urban, Bujqësor dhe Natyror";
- Në nenin 38 "Kufizime sektoriale", shfuqizohet fraza "Varreza 300m";
- Pas nenit 38 "Kufizime sektoriale", shtohet neni 38/1 "Vija Blu" dhe neni 38/2 "Burimet e ujrave";
- Në nenin 55 "Varrezat", paragrafi i parë me titull "Brezi Sanitar", ndryshohet;
- Pas nenit 69 "Brezat e rezervuara jashtë dhe në qendrat e banuara", shtohet neni 69/1 "Kufizimi i ndërtimeve përgjatë rrugëve të kategorive A, B dhe C";
- Pas nenit 74 "Furnizimi me energji elektrike", shtohet neni 74/1 "Energjitë e rinovueshme";
- Pas nenit 75 "Telekomunikacioni", shtohet neni 75/1 "Hekurudhat" dhe neni 75/2 "Kanalet vaditëse/Emisaret";
- Neni 78 "Zgjidhja e paqartësive bazuar në sakëtësinë e informacionit", ndryshohet;
- Tabelat e treguesve të zhvillimit të njësive strukturore;

- *Ndryshime të "Hartës së infrastrukturës së transportit të propozuar të Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Vau i Dejës".*

sipas Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Vau i Dejës, bashkëlidhur këtij Vendimi.

2. Ngarkohen Bashkia Vau i Dejës dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.
3. Ngarkohen Bashkia Vau i Dejës, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI BAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



[Handwritten signature in blue ink]

[Handwritten signature in blue ink]

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT



LEDIA TOFA